



DREJTORIA E PËRGJITHSHME E TATIMEVE

# BULETINI

## I

# UDHËZIMEVE TEKNIKE

(Gusht 2016 – Korrik 2017)



---

© Asnjë pjesë e këtij publikimi nuk mund të riprodhohet, përkthehet, përshtatet, rregullohet ose të ndryshohet në çdo lloj mënyre, të shpërndahet, komunikohet, huazohet, ruhet në sisteme të dhënash, apo të transmetohet në çdo formë a mënyrë, elektronike, mekanike, të fotokopjohet, regjistrohet apo të shfaqet për publikun, apo të jetë objekt i çdo veprimi a aktiviteti që ligji e mbron në favor të zotëruesit të të drejtës së autorit, pa lejen paraprake me shkrim nga DPT.

---

Adresa: Rr. Gjin Bue Shpata, pranë Stadiumit Dinamo  
Tel: ++ 355 42276820, Fax: ++355 42276805

Web site: [www.tatime.gov.al](http://www.tatime.gov.al)



## DREJTORIA E PËRGJITHSHME E TATIMEVE

### TABELA PËRMBLEDHËSE

<b>I.</b>	Hyrje.....	4
<b>II.</b>	Sqarim mbi zbatimin korrekt të nenit 33/1 të ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar.....	5 - 7
<b>III.</b>	Mbi zbatimin e Udhëzimit nr.5, datë 30.01.2006 "Për tatimin mbi të ardhurat", I ndryshuar, pika 2.3., "Të ardhurat e tatueshme", paragrafi 2.3.10, Nr.15889 Prot, datë 06.07.2017.....	8 - 11
<b>IV.</b>	Sqaruese mbi trajtimin e kërkesave të subjekteve për përdorimin e më shumë se një modeli fature tatimore, Nr.17712 Prot, dt.27.07.2017.....	12 - 13
<b>V.</b>	Raste specifike të tatimpaguesve të trajtuara për problematika të hasura në praktikë.....	14 - 23
	<b>1. Nga fusha e Tatimit mbi Vlerën e Shtuar</b>	
	<i>1.1. Saktësimi i vlerës së tatueshme kur tatimpaguesi është përpara situatës së anulimit apo tërheqjes prej furnizimit.</i>	
	<i>1.2 Mbi furnizimin e shërbimit të transportit ndërkombëtar të mallrave</i>	
	<b>2. Nga fusha e ligjit të Tattimit mbi të Ardhurat</b>	
	<i>2.1 Njohja për efekt fiskal të faturave të lëshuara nga personat jo-rezidentë</i>	
	<i>2.2 Burimi i të ardhurave dhe tatimi i tyre</i>	
	<b>3. Nga fusha e punësimit dhe sigurimeve Shoqërore</b>	
	<i>3.1 Në lidhje me dypunësimin dhe deklarimin e tyre për efekte të kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetsore.</i>	



**DREJTORIA E PËRGJITHSHME E TATIMEVE**

*3.2 Një trajtim mbi marrëdhënien e punësimit të vazhdueshëm dhe kontratave të shërbimit*



## DREJTORIA E PËRGJITHSHME E TATIMEVE

### I. Hyrje

Administrata tatimore ushtron detyrat e saj funksionale bazuar në ligjin organik nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në RSH”, i ndryshuar, dhe garanton zbatimin korrekt të legjislacionit tatimor, i cili perbëhet nga:

- a) Marrëveshjet ndërkombëtare, të ratifikuara nga Kuvendi
- b) Ligjet tatimore
- c) Aktet nënligjore, të miratuara në mbështetje të ligjeve tatimore

Në zbatim të Nenit 10, pika 3 e ligjit “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, përgatit komantarë përmbledhës të vendimeve teknike, në lidhje me mënyrën e trajtimit tatimor të rasteve specifike, duke i grupuar ato sipas natyrës së tyre.

Në funksion të zbatimit korrekt të kuadrit ligjor tatimor, referuar nenit 28 të ligjit nr.9920 “Për procedurat tatimore në RSH”, i ndryshuar, administrata tatimore ka për detyrë që, duke përdorur të gjitha mjetet e komunikimit, përfshirë median e shkruar dhe atë elektronike, të informojë publikun për përmbajtjen, rolin dhe rëndësinë e legjislacionit tatimor.

Gjatë vitit të fundit Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve në zbatim të detyrave të saj funksionale ka trajtuar me dhjetëra shkresa e kërkesa të tatimpaguesve apo edhe të strukturave të saj të varësisë në trajtimin e një sërë problematikash që kanë të bëjnë me zbatimin e legjislacionit tatimor, me procedurat e kontrollit apo edhe me problematika që kanë të bëjnë dhe me raste praktike dhe specifike.

Referuar sa më sipër, DPT vjen me këtë Buletin, i cili është një përmbledhje e qëndrimeve, opinioneve dhe udhëzimeve që kanë unifikuar qasjen e administratës tatimore kundrejt tatimpaguesve. Periudha që përfshin ky buletin është fundi i vitit 2016 deri në datën 31.07.2017.

Gjithashtu në fund të kësaj përmbledhje, jepen edhe disa trajtime për raste konkrete që tatimpagues i kanë parashtruar si kërkesa për interpretim apo sqarim lidhur me çështje të ndryshme të ligjeve tatimore, në mënyrë të veçantë me dy ligjet kryesore tatimore, ligjin nr.92/2014 “Për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar”, i ndryshuar, dhe Ligjin Nr. 8438, datë 28.12.2008 “Për Tatimin mbi të Ardhurat”, i ndryshuar, por gjithashtu edhe nga fusha e kontributeve të detyrueshme të sigurimive shoqërore e shëndetsore.



## DREJTORIA E PËRGJITHSHME E TATIMEVE

### II. Sqarim mbi zbatimin korrekt të nenit 33/1 të ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar

Nr. 11104 Prot

Tiranë, më 17/05/2017

**Drejtuar:** Drejtoria Rajonale Tatimore

---

**Për Dijeni:** Zv. Drejtor i Përgjithshëm i Hartimit të Programeve  
Zv. Drejtor i Përgjithshëm i Mbështetjes së Programeve  
Zv. Drejtor i Përgjithshëm Territorial  
Drejtoria e Kontrollit Tatimor  
Drejtoria e Menaxhimit të Riskut  
Drejtoria e Shërbimit të Tatimpaguesve  
Drejtoria e Mbledhjes me Forcë  
Drejtoria e Rimbursimit TVSH-së  
Drejtoria e Hetimit Tatimor  
Drejtoria e Auditit të Brendshëm  
Drejtoria e Analizës dhe e Kontabilitetit

Këtu

**Lënda:** Sqarim lidhur me zbatimin korrekt të nenit 33/1 të Ligjit nr. 8438, dt. 28.12.1998 “Për Tatimin mbi të Ardhurat” i ndryshuar.

Marrë shkas nga disa problematika të hasura në praktikë, lidhur me trajtimin ligjor të procedurës së shpërndarjes së dividendit nga tatimpaguesit subjekte të tatimit mbi fitimin dhe me qëllim sqarimin e situatës si edhe unifikimin e qëndrimit, ju bëjmë me dije si më poshtë:



## DREJTORIA E PËRGJITHSHME E TATIMEVE

Të gjithë tatimpaguesit, që janë subjekt i tatimit mbi fitimin, pas pagimit të tij, brenda 6 mujorit të parë të çdo viti (brenda datës 30 Qershor), kanë detyrimin ligjor të miratojnë rezultatet financiare të vitit paraardhës.

Po ashtu këta tatimpagues, duhet të depozitojnë pranë organeve tatimore, deri në datën 31 Korrik, vendimin e organit kompetent vendimmarrës të shoqërisë për përdorimin e fitimit pas tatimit të vitit paraardhës. Në çdo rast të zakonshëm të miratimit për shpërndarje të dividendit, tatimi përkatës, duhet të derdhet nga shoqëria në favor të organit tatimor brenda afateve ligjore në fuqi. Në Ligjin nr.8438, dt.28.12.1998 “Për Tatimin mbi të Ardhurat” i ndryshuar, në nenin 33/1 “Depozitimi i vendimit për miratimin e rezultatit vjetor dhe destinimi i fitimit” përcaktohet se:

1. Shoqëritë tregtare, sipas ligjit "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", të ndryshuar, pas pagimit të tatimit mbi fitimin, sipas dispozitave të kreut III të këtij ligji, brenda një afati prej 6 muajsh nga data e mbylljes së vitit financiar, duhet të miratojnë në asamblenë e ortakëve apo organin kompetent vendimmarrës të shoqërisë rezultatet financiare të vitit paraardhës dhe ta destinonjë fitimin pas tatimit, duke përcaktuar shumën e rezervave ligjore, pjesën që do të përdoret për investime ose për shtesë kapitali dhe pjesën që do të shpërndahet në formë dividendi.
2. Shoqëritë tregtare dhe personat fizikë, sipas pikës 1 të këtij neni, duhet të depozitojnë pranë organeve tatimore, jo më vonë se data 31 korrik e vitit kalendarik, vendimin e organit përgjegjës/vendimin e personit fizik.
3. Personi juridik duhet të deklarojë dhe të paguajë për llogari të administratës tatimore tatimin mbi dividendin e pagueshëm, sipas pikës 1, të këtij neni, jo më vonë se data 20 gusht e vitit kur bëhet miratimi i rezultateve, pavarësisht nëse është bërë ose jo shpërndarja e dividendit.

Sipas kërkesave të ligjit të tatimit mbi të ardhurat, në qoftë se tatimpaguesit nuk e depozitojnë vendimin e organit vendimmarrës deri në datën 31 Korrik pranë organit tatimor, përsa i përket destinacionit të fitimit, atëherë i gjithë ky fitim pa përfshirë rezervat e domosdoshme ligjore, konsiderohet dividend për t'u shpërndarë dhe do tatohet me 15%.

Po ashtu çdo zvogëlim kapitali, që nuk ka për qëllim mbulimin e humbjeve dhe që nuk përbën kontribut në para të pronarëve, konsiderohet dividend i tatuueshëm. Në këtë rast tatimi duhet të mbahet në burim dhe derdhet nga shoqëria në favor të tatimeve brenda 30 ditëve nga data e marrjes së vendimit për zvogëlimin e kapitalit.

Në rast se, asambleja e ortakëve apo organi kompetent vendimmarrës i shoqërisë merr vendim për rezultatet financiare të vitit/viteve paraardhës, duke përcaktuar pjesën që do të shpërndahet në formë dividendi, pas afatit të përcaktuar në nenin 33/1 të sipërcituar, përsa nuk përcaktohet nga legjislacioni tatimor tatimpaguesit i referohen dispozitave të ligjit nr.9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” i ndryshuar.



## **DREJTORIA E PËRGJITHSHME E TATIMEVE**

Sipas dispozitave të ligjit “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar vendimmarrja për shpërndarjen e fitimit të shoqërisë i përket Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve në shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar apo Asamblesë së Përgjithshme të Aksionarëve në shoqëritë aksionare. Pra pavarësisht faktit se shoqëria ka fitime ushtrimore, shoqëria mund të destinojë fitimin për përdorime të tjera (p.sh t’i kalojë në rezerva, të kryeje investime etj) dhe e drejta për dividend lind vetëm kur shpërndarja miratohet shprehimisht nga Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve/Aksionarëve.

Në ligjin nr.9901/2008“Për tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, i ndryshuar, Neni 76, përcakton se, me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në statut, ortakët kanë të drejtë të ndajnë pjesën e fitimit të deklaruar në pasqyrat financiare të shoqërisë. Me përjashtim të rasteve të parashikuara në statut, fitimi u shpërndahet ortakëve në raport me kuotat e zotëruara.

Në nenin 81, pika 1/gërma “e” të ligjit nr.9901/2008, mbledhja e zakonshme e asamblesë së ortakëve thirret, ndër të tjera edhe për zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit (zvogëlimi i kapitalit të vet shoqërisë vjen edhe nga tërheqjet e dividendit). Më tej në nenin 82, pika 1 e ligjit të sipërcituar, përcaktohet se, mbledhja e zakonshme e asamblesë së ortakëve thirret të paktën 1(një) herë në vit.

Pra siç shihet, e drejta për të marrë vendime nuk kufizohet në kohë. Në asnjë dispozitë të këtij ligji nuk parashikohen kufizime në afat për marrjen e vendimit për shpërndarjen e fitimeve për shoqëritë tregtare.

Ligji nr.9901, datë 14.04.20008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, i ndryshuar, ka përcaktuar detyrimin e shoqërive tregtare për organizimin dhe mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme të paktën një herë në vit, për të ushtruar kompetencat e parashikuara në legjislacionin në fuqi dhe nuk ekziston ndonjë kufizim ligjor, apo kufizime të mundshme në lidhje me shpërndarjen e fitimit, të cilat nëse ka, do të mund të gjenden vetëm në aktet e shoqërisë miratuar nga ortakët/aksionarët.

## **DREJTOR I PËRGJITHSHËM**

**VASILIKA VJERO**



## DREJTORIA E PËRGJITHSHME E TATIMEVE

**III. Mbi zbatimin e Udhëzimit nr.5, datë 30.01.2006 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, pika 2.3., "Të ardhurat e tatueshme", paragrafi 2.3.10, Nr.15889 Prot, datë 06.07.2017**

Nr. 15889 Prot

Tiranë, më 06/07/2017

**Drejtuar:      Drejtoria Rajonale Tatimore**

**Për dijëni:      Zv. Drejtor i Përgjithshëm i Hartimit të Programeve  
Zv. Drejtor i Përgjithshëm i Mbështetjes së Programeve  
Zv. Drejtor i Përgjithshëm Territorial  
Drejtoria e Kontrollit Tatimor  
Drejtoria e Menaxhimit të Riskut  
Drejtoria e Shërbimit të Tatimpaguesve  
Drejtoria e Mbledhjes me Forcë  
Drejtoria e Rimbursimit TVSH-së  
Drejtoria e Hetimit Tatimor  
Drejtoria e Auditit të Brendshëm  
Drejtoria e Analizës dhe e Kontabilitetit**

**Këtu**

**Lënda:      Mbi zbatimin e Udhëzimit nr.5, datë 30.01.2006 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, pika 2.3. "Të ardhurat e tatueshme", paragrafi 2.3.10.**

Bazuar në ligjin Nr. 9920, datë 19.05.2008 "Për Procedurat Tatimore në RSH", i ndryshuar, Neni 10, "Udhëzimet Teknike", pika 2, si dhe për zbatimin korrekt të pikës 2.3.10 të Udhëzimit nr.5, datë 30.01.2006, "Për Tatimin mbi të Ardhurat", i ndryshuar, të mbahen parasysh orientimet si më poshtë:

Shoqëritë tregtare funksionojnë në bazë të ligjit Nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", i ndryshuar, si dhe në bazë të ligjeve specifike që rregullojnë fushat e tyre të veprimtarisë së biznesit.



## DREJTORIA E PËRGJITHSHME E TATIMEVE

Tregtarët dhe shoqëritë tregtare regjistrohen në Qendrën Kombëtare të Biznesit, në përputhje me këtë ligj dhe me ligjin nr.9723, datë 3.5.2007 “Për Regjistrimin e Biznesit”, të ndryshuar.

Gjithashtu, në përmbushje të standarteve dhe detyrimeve ligjore, tregtarët dhe shoqëritë tregtare mbajnë libra kontabël, hartojnë e publikojnë të dhënat financiare dhe raportet për gjendjen e ecurisë së veprimtarisë, përfshirë dhe raportet e kontrollit të ekspertëve kontabël të autorizuar në përputhje me ligjin për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare.

Në aspektin e fiskut, tregtarët dhe shoqëritë tregtare janë tatimpagues, që i nënshtrohen dhe janë të detyruar të zbatojnë legjislacionin tatimor në fuqi. Nga ana tjetër, në veprimtarinë e tyre të ushtrimit të aktivitetit, shoqërive tregtare iu duhet të kujdesen edhe për shumë procedura administrative e organizative që rregullojnë funksionimin e tyre, të cilat iu janë besuar organeve të brendshme të shoqërisë siç është asambleja e ortakëve apo aksionarëve që të marrin vendime dhe të përcaktojnë politikat e shoqërisë. Një nga vendimarrjet më të shpeshta me të cilat përballet shoqëria tregtare është edhe vendimarrja për zmadhimin e kapitalit.

Në kuptim të dispozitave ligjore të ligjit për shoqëritë tregtare, zmadhimi i kapitalit në shoqëri vjen edhe nga kontributi i ortakëve/aksionarëve me mjete monetare nga jashtë shoqërisë.

Për të përmbushur këtë qëllim, individi kontribues, referuar ligjit nr.8438, dt.28.12.1998 “Për Tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, duhet të tregojë burimin e këtyre të ardhurave si dhe faktin nëse këto të ardhura janë tatuar sipas parashikimeve ligjore për tatimin mbi të ardhurat personale.

Në Udhëzimin nr.5, dt.30.01.2006, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, pika 2.3.10, gërma h) përcaktohet se, në të ardhura të tatueshme për qëllim të tatimit mbi të ardhurat personale, përfshihen të ardhurat e individëve, në formë monetare që shkojnë për shtimin e kapitalit të shoqërisë, të përfituara nga jashtë shoqërisë.

Nëse këto të ardhura të individëve nuk janë tatuar më parë, ndërkohë që kanë qenë e janë objekt i tatimit dhe pagesës së tatimit mbi të ardhurat personale, për këto të ardhura paguhet tatimi në masën 15%. Lidhur me origjinën e krijimit të të ardhurave, që shkojnë për rritjen e kapitalit të shoqërisë me mjete monetare nga jashtë shoqërisë nga individi investues, kërkuesi duhet të deklarojë lidhur me origjinën e të ardhurave personale.

Ky deklaram duhet të paraqitet sipas **Formularit 1 “Deklarimi i individit kontribues në shtimin e kapitalit në formë monetare nga jashtë shoqërisë”**, që i bashkëlidhet këtij udhëzimi si pjesë përbërëse e tij, jo më vonë se data e derdhjes së të ardhurave për shtimin e kapitalit të shoqërisë në Qendrën Kombëtare të Biznesit (QKB).

Për individët e huaj ky deklaram duhet të paraqitet sipas **Formularit 2 “Deklarimi i individit kontribues të huaj në shtimin e kapitalit në formë monetare nga jashtë shoqërisë”**, që i bashkëlidhet këtij udhëzimi si pjesë përbërëse e tij. Bazuar në ligjin për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë individët e huaj kanë të drejtë të emërojnë me prokurë, një person, i cili e përfaqëson atë në raport me administratën tatimore, në rastet e pamundësisë për t’u paraqitur për kryerjen e veprimeve të mësipërme.



## DREJTORIA E PËRGJITHSHME E TATIMEVE

Në këtë deklaram duhet përshkruar burimi i këtyre të ardhurave dhe bashkëngjitur me këtë deklaram, duhet të vendoset dokumentacioni plotësues zyrtar që vërteton shumën e këtyre të ardhurave dhe pagesën e tatimit mbi të ardhurat personale, përpara se këto të ardhura të investohen për shtimin e kapitalit të shoqërisë.

Nëse ky dokumentacion mungon ose nuk vërteton, që për vlerën e plotë të të ardhurave të kontribuara është paguar tatimi mbi të ardhurat personale, mbi këtë vlerë të të ardhurave duhet të paguhet tatimi mbi të ardhurat në masën 15%.

Ky tatim do të paguhet në të njëjtën datë që individi do të deklarojë të ardhurën monetare për shtimin e kapitalit të shoqërisë pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit. Paga e tatimit mbi të ardhurën për kontributin në kapitalin e shoqërisë duhet të derdhet nga individi kontribues, në llogarinë bankare të Drejtorisë Rajonale Tatimore, ku shoqëria është e regjistruar, me përshkrimin në dokumentin bankar të pagesës: Derdhur tatim mbi të ardhurat për shtimin e kapitalit të shoqërisë.

Pra, përpara përcaktohet në dispozitat e Udhëzimit “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, individi ndodhet përpara tre situatave dhe duhet:

1. Të deklarojë dhe të paguajë tatimin mbi të ardhurat personale në rast se të ardhurat personale janë të ardhura që i nënshtrohen përcaktimeve ligjore në nenin 8 “Të ardhura të tatueshme” të Ligjit nr.8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, dhe për këto të ardhura personale të tatueshme nuk është paguar tatimi mbi të ardhurat personale.
2. Të deklarojë dhe të vërtetojë se të ardhurat janë janë gjeneruar nga burime të tilla, për të cilat është paguar tatimi sipas dispozitave ligjore ose tataimi quhet I paguar për shkak të ligjit, si:
  - a) akte administrative apo vendime gjyqësore, qe janë të përjashtuara nga tatimi mbi të ardhurat personale sipas dispozitave të nenit 8/1 të ligjit nr.8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar;
  - b) kalimi i të drejtës së pronësisë së pasurisë së paluajtshme, për të cilat nuk ka fitim kapital e për rrjedhojë nuk ka detyrimin ligjor për të paguar tatimin mbi të ardhurat personale sipas përcaktimeve të nenit 11 të ligjit “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar;
  - c) nga procesi ligjor i rivlerësimit të pasurive të paluajtshme, ku individi ka zbatuar dispozitat e ligjit nr.81/2016, datë 25.07.2016 “Për rivlerësimin e pasurisë së paluajtshme” si dhe të Udhëzimit nr.19, datë 26.08.2016, duke e rivlerësuar pasurinë e paluajtshme në vlerën e tregut. Për këtë individi paguan tatimin mbi të ardhurat personale sipas përcaktimeve ligjore. Në rast se individi kalon të drejtën e pronësisë së pasurisë së paluajtshme pas rivlerësimit dhe nuk ka fitim kapital, tatimi përfundimtar mbi të ardhurat



## DREJTORIA E PËRGJITHSHME E TATIMEVE

personale është ai i përcaktuar në dispozitat e ligjit “Për rivlerësimin e pasurisë së paluajtshme”.

- d) të ardhurat nga shitja e aksioneve apo kuotave në vlerë nominale;
  - e) të ardhurat nga shitja e automjeteve;
  - f) çdo e ardhur tjetër, e ndryshme nga të mësipërmet, e trajtuar rast pas rasti me kushtin që të jetë e dokumentuar sipas parashikimeve ligjore.
3. Të deklarojë dhe të vërtetojë se të ardhurat janë me burim jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, të cilat i nënshtrohen dispozitave ligjore që burojnë nga marrëveshjet tatimore për eliminimin e taksimit të dyfishtë.

Individi që do të investojë për rritjen e kapitalit, duhet të bëjë deklarimin për burimin e këtyre të ardhurave duke e justifikuar me dokumentacionin përkatës dhe Drejtoria Rajonale Tatimore, duhet të pajisë tatimpaguesin me vërtetim ku të përshkruhet burimi i të ardhurës dhe që këto të ardhura nuk janë objekt i tatimit mbi të ardhurat personale.

**DREJTOR I PËRGJITHSHËM**

**VASILIKA VJERO**



## DREJTORIA E PËRGJITHSHME E TATIMEVE

### IV. Sqaruese mbi trajtimin e kërkesave të subjekteve për përdorimin e më shumë se një modeli fature tatimore, Nr.17712 Prot, dt.27.07.2017

Nr. 17712 Prot.

Tiranë, më 27 / 07 / 2017

**Lënda:** Sqaruese mbi trajtimin e kërkesave të subjekteve për përdorimin e më shumë se një modeli faturë tatimore

### DREJTORIA RAJONALE TATIMORE

---

Për dijeni:      Zv. Drejtor i Përgjithshëm i Hartimit të Programeve  
Zv. Drejtor i Përgjithshëm i Mbështetjes së Programeve  
Zv. Drejtor i Përgjithshëm Territorial  
Drejtoria e Kontrollit Tatimor  
Drejtoria e Menaxhimit të Riskut  
Drejtoria e Shërbimit të Tatimpaguesve  
Drejtoria e Mbledhjes me Forcë  
Drejtoria e Rimbursimit TVSH-së  
Drejtoria e Hetimit Tatimor  
Drejtoria e Auditit të Brendshëm  
Drejtoria e Analizës dhe e Kontabilitetit

Këtu

Marrë shkas nga kërkesat e DRT-ve, por edhe të tatimpaguesve lidhur me mundësinë e përdorimit njëkohësisht të faturave kompjuterike elektronike pas një autorizimi të lëshuar nga Drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve, si dhe pajisjes me diapazonin përkatës nga DRT përkatëse, po ashtu edhe të përdorimit të formatit ekzistues me numër serial të parashtypur, lidhur me bazueshmërinë ligjore, të mbahen parasysh orientimet si më poshtë:

Në bazë të ligjit nr.9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në RSH”, i ndryshuar, në kreun IV “Mbajtja e të dhënave”, Seksioni I, “Detyrimi për dokumentimin dhe mbajtjen e llogarive për qëllime tatimore”, Neni 46 e vijues, përcaktohen kushtet dhe detyrimi i tatimpaguesve për dokumentimin e të gjitha transaksioneve që ata realizojnë, ku sipas përcaktimit në nenin 48, pika 4, tatimpaguesi për çdo shitje, lëshon fataturë tatimore ose kupon tatimor.



## DREJTORIA E PËRGJITHSHME E TATIMEVE

Më tej në këtë seksion, në Nenin 50, pika 1 e ligjit Nr. 9920/2008, përcaktohet detyrimi i tatimpaguesve që i nënshtrohen tatimit mbi vlerën e shtuar (TVSH-së), që sa herë ofrojnë mallra apo shërbime duhet të lëshojë një faturë tatimore me TVSH, sipas formës së caktuar nga Ministri i Financave dhe përmbytjes të parashikuar në ligjin Nr. 92/2014 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në RSH”, i ndryshuar, neni 101 “Përmbytja e faturës”.

Ndërkohë në nenin 52 “Prodhimi dhe shpërndarja e dokumenteve tatimore”, pika 4, si dhe në Udhëzimin Nr. 24, dt.02.09.2008 “Për Procedurat tatimore në RSH”, i ndryshuar, pika 52.4, është parashikuar e drejta e tatimpaguesit, që duke përbushur kërkesat ligjore të parashikuara në këto dispozita, të verifikuara dhe kundrejt një autorizimi nga Drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve të përdorin faturat kompjuterike, me numër serial unik dhe të papërsëritshëm, të printuara nga sistemi i tij i regjistrimeve.

Ndërkohë nga ana tjetër, është vënë re se, një pjesë e tatimpaguesve, krahas përdorimit të faturave kompjuterike, kërkojnë edhe pajisjen me blloqe tatimore të parashtypura nga DRT-të përkatëse, duke ndjekur procedurën e zbatuar deri më tani, dhe sipas një verifikimi/konstatimi, është vërejtur se, ka shumë tatimpagues që operojnë në bazë të dy modeleve faturash tatimore.

Arsyeja e përdorimit të dy modeleve, sipas tyre është ushtrimi i veprimtarisë në më shumë se një adresë apo në rastet e kompanive të mëdha që u shërbejnë një numri të konsiderueshëm konsumatorësh, si OSHEE, Ujësjiellës-Kanalizime, kompanitë telefonike.etj.,.

Në këto kushte, duke qenë se nuk ka ndonjë dispozitë ligjore, e cila të përcaktojë në mënyrë përjashtuese, se përdorimi i njërit format, nuk lejon përdorimin e formatit tjetër, si dhe bazuar në parimet e funksionimit të administratës tatimore, të përcaktuara në nenin 12 të ligjit nr.9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në RSH”, i ndryshuar, si dhe dispozitave ligjore të Kreut IV “Të drejtat e tatimpaguesit”, DRT-të të marrin në shqyrtim të gjitha kërkesat rast pas rasti dhe të pajisin me blloqe tatimore edhe subjektet që kanë filluar përdorimin e faturave kompjuterike, kur ata parashtrojnë arsye të qenësishme, për nevojën e përdorimit të dy formateve, duke vënë në dijeni Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, por edhe duke njoftuar drejtoritë e kontrollit pranë DRT-ve.

**DREJTOR I PËRGJITHSHËM**

**Vasilika Vjero**



## DREJTORIA E PËRGJITHSHME E TATIMEVE

### V. Raste specifike të tatimpaguesve

#### 1. Nga fusha e Tatimit mbi Vlerën e Shtuar

##### *1.1 Saktësimi i vlerës së tatueshme kur tatimpaguesi është përpara situatës së anulimit apo tërheqjes prej furnizimit.*

Në përgjigje të shkresës tuaj, datë 23.03.2017, ju sqarojmë si më poshtë sqarojmë se:

Bazuar në ligjin Nr.92/2014 datë 24.07.2014 “Për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, neni 41 dhe udhezimin Nr.6 datë 30.01.2015 “Për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, neni 32 “Saktësimi i Vlerës së Tatueshme”, janë parashikuar rastet kur lejohet të bëhet një saktësim i TVSH-së së faturuar prej furnizuesit të mallit/shërbimit, **në rast anulimi apo tërheqje prej furnizimit ose një reduktim i çmimit pas momentit të kryerjes së furnizimit.** Vlera e tatueshme saktësohet duke u reduktuar në përputhje me rregullat dhe procedurën e përcaktuar.

Me anulim apo tërheqje prej furnizimit në funksion të zbatimit të këtij neni kuptohet:

*- një furnizim do të konsiderohet i anuluar, në datën kur, pasi është bërë porosia dhe kryer parapagesa, blerësi, i cili nuk do ta vazhdojë këtë porosi, i kërkon shitësit t’i kthejë (rimbursojë) shumën e parapagesave të bëra.*

*- furnizimi do të konsiderohet i tërhequr, në datën kur palët rivendosen në situatën që ishin para realizimit të furnizimit. Pra mallrat i kthehen shitësit pasi furnizimi nuk është i njëjtë me atë që ka kërkuar blerësi ose mallrat janë të dëmtuara ose shërbimi nuk është kryer.*

Lidhur me rastin e paraqitur në shkresën tuaj, nuk jemi në kushtet e saktësimit të vlerës së tatueshme, dmth anulimi, apo tërheqje prej furnizimit, ose një reduktim i çmimit pas momentit të kryerjes së furnizimit, ose mallrat janë të dëmtuara ose shërbimi nuk është kryer, por me kthimin e mallit, si rezultat mbarimit të afatit të skadencës, bazuar kjo e fundit në kontratën e lidhur midis palëve.

Pra, nëse problemin e trajtojmë nga ana fiskale dhe kontabël, klienti juaj, duhet të lëshojë një faturë shitje duke ju referuar kontratës lidhur midis palëve dhe ku të bëhet një përshkrim qartë I transaksionit në faturën tatimore.

Në ligjin Nr.92/2014 datë 24.07.2014 “Për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, neni 36 dhe udhezimin Nr.6 datë 30.01.2015, dalë për dhe në zbatim të ligjit në fjalë, neni 34 përcaktohet nocioni i vlerës së tregut për transaksionet, ku me “vlerë tregu”



## DREJTORIA E PËRGJITHSHME E TATIMEVE

do të kuptohet shuma e plotë që blerësi, për të përfituar mallrat apo shërbimet në të njëjtën fazë të tregtimit në të cilën furnizimi kryhet, duhet t'i paguajë në kushtet e konkurrencës së barabartë furnizuesit të mallit/shërbimit, i cili vepron si i pavarur në kushtet e tregut në territorin e Republikën e Shqipërisë, në të cilin ky furnizim është subjekt i tatimit.

Në qoftë se nuk mund të sigurohen vlera të krahasueshme për furnizimet e mallrave ose shërbimeve, atëherë me termin “vlerë tregu” kuptohen, një shumë jo më e vogël se çmimi i blerjes së mallit apo të mallrave të ngjashme ose, në mungesë të çmimit të blerjes, sa vlera e koston e përcaktuar në kohën e furnizimit.

Vlera e tatueshme e një furnizimi është vlera që është përcaktuar në nenin 37 të ligjit, e cila zbatohet në çdo rast, me përjashtim të rregullave të veçanta të përcaktuara në neni 38, pika 1, 2, 3 të ligjit ku përfshihen rastet që konsiderohen si furnizim kundrejt pagesës.

Në raste kur vlera e tatueshme e një transaksioni nuk është e mundur të përcaktohet bazuar në nenin 37 të ligjit, atëherë autoriteti tatimor për çdo rast përfshirë edhe ato të përmendura me poshtë aplikon vlerën e tregut sipas përcaktimit në nenin 36 të ligjit.

### *1.2 Mbi furnizimin e shërbimit të transportit ndërkombëtar të mallrave*

Për të përcaktuar tatueshmërinë e shërbimit të transportit ndërkombëtar të mallrave është e nevojshme të analizojmë sipas konceptit të vendit të furnizimit të shërbimit. Bazuar në nenin 24 të Ligjit Nr. 92/2014 date 24.07.2014 “Për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, vendi i furnizimit të shërbimit është në Shqipëri, kur marrësi i shërbimit është një person i tatueshëm që vepron si i tillë dhe ka në Shqipëri, selinë e veprimtarisë së tij ekonomike apo një vendndodhje të qëndrueshme për të cilën janë kryer shërbimet ose në mungesë të tyre, ka banesën ose rezidencën e zakonshme.

Vendi i furnizimit të shërbimit të transportit të mallrave nga një person i tatueshëm për një person të tatueshëm, përsa ligji nuk përcakton ndryshe është në vendin e marrësit të shërbimit dhe aplikimi i TVSH-së bëhet sipas rasteve të mëposhtme:

**Së pari**, në rastin kur marrësi i shërbimit të transportit ndërkombëtar të mallrave është një person i tatueshëm në Shqipëri, vendi i furnizimit të shërbimit të transportit është në Shqipëri. Ky shërbim është i tatueshëm me TVSH 20% në Shqipëri, pavarësisht destinacionit të mallrave.

**Së dyti**, nëse personi i tatueshëm marrës i shërbimit të transportit të mallrave me destinacion jashtë Shqipërisë është një person i tatueshëm jashtë Shqipërisë atëherë vendi i tatimit është në vendin e



## DREJTORIA E PËRGJITHSHME E TATIMEVE

marrësit, sipas rregullit të përgjithshëm të përcaktuar në ligj mbi vendin e furnizimit të shërbimit. Ky furnizim shërbimi nuk është i tatueshëm në Shqipëri kur marrësi i shërbimit është një person i tatueshëm jashtë Shqipërisë.

**Së treti**, bazuar në nenin 57 pika d) të ligjit Nr. 92/2014 datë 24.07.2014 “Për TVSH-në në Republikën e Shqipërisë”, në rastin kur transporti ndërkombëtar i mallrave është një proces i vazhdueshëm përfshirë eksportin e mallrave që transportohen deri në dorëzimin e tyre në destinacionin që ndodhet jashtë territorit shqiptar, atëherë pavarësisht vendit ku fillon transporti i mallrave, ky shërbim transporti konsiderohet shërbim i lidhur drejtëpërdrejtë me eksportin e mallrave dhe zbatohet shkalla e TVSH-së 0%.

Ndërkohë siç përcaktohet në pikën 3, gërma c) të nenit 50 të Udhëzimit Nr.6 datë 30.01.2015 “Për TVSH-në në Republikën e Shqipërisë” të ndryshuar, transportuesi duhet të vërtetojë që ka kryer shërbimin e transportit ndërkombëtar deri në destinacionin jashtë Shqipërisë, të mallrave për të cilat vërteton se është kryer procedura e eksportit, nëpërmjet deklaratës së eksportit.

Gjithashtu transportuesi duhet të regjistrojë dhe të paraqesë:

- një vërtetim të lëshuar nga pronari i mallit, me anë të të cilit ai vërteton se transporti është kryer për mallrat e destinuar për eksport. Vërtetimi duhet të lëshohet jo më vonë se momenti i faturimit të transportit dhe në të duhet të jenë shkruar përveç destinacionit të produkteve dhe emrit të klientit, karakteristikat e mallrave të transportuara.
- të regjistrojë për çdo transport në kontabilitetin e tij ose në librin e veçantë të transportit, transportet e kryera jashtë Shqipërisë, duke treguar datën e regjistrimit, emrin dhe adresën e klientit të huaj;
- t’i bashkëngjisë kontabilitetit vërtetimet që i janë dorëzuar nga klientët e huaj dhe kopjet e faturave që këta të fundit duhet t’i dërgojnë, duke shënuar me korrektësi referencat (numrat, datat, pikat e hyrjes doganore) në deklaratat e eksportit të mallrave të transportuara.

Transportuesit i duhet të provojë dhe të posedojë të gjitha vërtetimet që tregojnë se mallrat e transportuara e kanë kaluar efektivisht kufirin, autorizimin e transportit ndërkombëtar të lëshuar nga autoritetet përkatëse.

Prova për dërgesën e mallrave me destinacion një vend tjetër mbështetet nga kopjet e faturave dhe sipas rastit, nga vërtetimet e dorëzimit të mallit apo nga fotokopjet e tyre kur këto dokumente të fundit, jo të detyrueshme, janë plotësuar nga dërguesi apo nën përgjegjësinë e tij. Nga ana tjetër, këto dokumente përbëjnë provën e dërgesës së mallrave drejt një vendi apo territori eksportues për transportet që nuk kanë nevojë për autorizim të veçantë të transportit ndërkombëtar.



## **DREJTORIA E PËRGJITHSHME E TATIMEVE**

Ju sjellim në vëmendje se nëse tatimpaguesi kryen shërbim transporti ndërkombëtar të mallrave në kushtet e nenit 57 gërma d) të Ligjit, por nuk është në gjendje të sigurojë dokumentacionin e kërkuar për të provuar kryerjen e shërbimit të transportit të mallrave jashtë territorit të Shqipërisë, siç përcaktohet në dispozitat e cituara në paragrafin më sipër, atëherë duhet të aplikojë TVSH 20% për shërbimin dhe klienti ka të drejtë të aplikojë zbritjen e TVSH-së në përputhje me aktivitetin që kryen.

Në çdo rast personi i tatueshëm që kryen transportin, duhet të vërtetojë që transporti ndërkombëtar i mallrave është bërë për një person të tatueshëm jashtë Shqipërisë si dhe të faktojë me dokumente udhëtimin e kryer jashtë, karakteristikat e mallit të transportuar si dhe të vërtetojë eksportin apo importin e mallit.



## DREJTORIA E PËRGJITHSHME E TATIMEVE

### 2. Nga fusha e ligjit të Tatimit mbi të Ardhurat

#### 2.1 Njohja për efekt fiskal të faturave të lëshuara nga personat jo-rezidentë

Në përgjigje të kërkesës tuaj datë 18.04.2017 me lëndë “Kërkesë për informacion”, protokolluar në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve nr.9046 prot, datë 20.04.2017, në lidhje me njohjen për efekt fiskal të faturave të lëshuara nga personat jo-rezidentë sqarojmë si më poshtë:

Ligji nr.8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, është ligji tatimor i cili rregullon marrëdhëniet në fushën e tatimit mbi të ardhurat personale, tatimit mbi fitimin si dhe tatimit të mbajtur në burim të të ardhurave.

Në nenin 19 të këtij ligji është përcaktuar, nocioni i fitimit të tatueshëm, i cili për periudhën tatimore përcaktohet në bazë të bilancit dhe të anekseve të tij, që duhet të jene në përputhje me ligjin “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, me dispozitat e këtij ligji, si dhe me aktet nënligjore të nxjerra nga Ministria e Financave. Në parim, fitimi ose e ardhura neto e tatueshme, del si rezultat i diferencës midis të ardhurave totale (të ardhurat nga aktiviteti normal dhe të ardhura të jashtëzakonshme), përfshirë vlerën e përfitimeve dhe të avantazheve në natyrë, me shpenzimet e kryera me qëllim realizimin dhe ruajtjen e të ardhurave.

Më tej, në nenin 20, të ligjit 8438 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, si dhe në pikën 3.5 të Udhëzimit nr.5, datë 30.01.2006, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, përshkruhen në mënyrë të hollësishme koncepti dhe elementët që përbëjnë shpenzimet e njohura për efekt të legjislacionit tatimor, ku ndër të tjera gjejmë këtë përshkrim, *citohet*:

*“Për përcaktimin e fitimit të tatueshëm në Republikën e Shqipërisë njihen si shpenzime ato që kryhen për qëllime fitimi, sigurimi dhe ruajtje të fitimit, në masën që këto shpenzime provohen dhe dokumentohen nga tatimpaguesi, si dhe kur janë objekt i kufizimeve të specifikuara nga ky ligj Për të qenë të njohura (të zbritshme) shpenzimet duhet të përmbushin këto kushte:*

- a) Të jenë kryer në interes të drejtëpërdrejtë të veprimtarisë ekonomike prej së cilës realizohen të ardhurat ose të jenë të lidhura me drejtimin normal të aktivitetit të tatimpaguesit;*
- b) Të jenë kryer ose të jene përballuar efektivisht dhe të jenë të mbështetur në dokumente justifikuese të njohura ligjërisht;*
- c) Në çdo rast shpenzimet duhet të jenë të provuara nga tatimpaguesit me dokumentacionin përkatës ligjor*

*Dokumente të përdorura si bazë për justifikimin e shpenzimit për efekt tatimor, është fatura tatimore me TVSH, fatura e thjeshtë tatimore, faturat e lëshuara nga persona jo-rezidentë që nuk*



## DREJTORIA E PËRGJITHSHME E TATIMEVE

*janë të regjistruar në organet tatimore shqiptare dhe çdo dokument tjetër i lëshuar nga ente ose organizma juridike, Ambasada të huaja, organizma ndërkombëtarë, zyra pune, komisariate policie, muzetë e institucioneve publike etj., për pagesat e tarifave të shërbimeve që këto ente i kryejnë tatimpaguesve, subjekt i tatimit mbi fitimin në Shqipëri.*

Theksojmë se, në çdo rast në faturën e lëshuar nga jorezidenti duhet të evidentohet saktë blerësi dhe të dhënat identifikuese të tij. Blerësi është tatimpaguesi rezident shqiptar, i cili ka marrë furnizime mallrash apo shërbimesh nga jorezidenti në interes të drejtpërdrejtë të veprimtarisë ekonomike prej të cilës ai realizon të ardhura. Në të gjitha rastet faturat e lëshuara nga jorezidentët do të deklarohen në librin e blerjeve të muajit përkatës, duke pasur parasysh njëkohësisht edhe lëshimin e autofaturës në rastin e shërbimeve.

### 2.2 *Burimi i të ardhurave dhe tatimi i tyre*

Në lidhje me shërbimet e ofruara nga subjekte jo rezidente tatimore shqiptare në referim të nenit 4 “Burimi i të ardhurave” të ligjit 8438, datë 28.12.2008 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar si dhe në pikën 1.4.1 të Udhëzimit nr.5, datë 30.01.2006 (i ndryshuar) në zbatim të ligjit, përcaktohet se “burimi i të ardhurave” është i rëndësishëm për të kuptuar mënyrën e përcaktimit të detyrimit tatimor të personave rezidentë dhe sidomos për personat jorezidente, të cilët taten në Shqipëri për të ardhurat me burim në Republikën e Shqipërisë.

Në nenin 4 të ligjit nr.8438, datë 28/12/1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar listohen të gjitha të ardhurat me burim në Republikën e Shqipërisë, por duke mos u kufizuar vetëm në atë listë. Për të përcaktuar të ardhurat me burim në Shqipëri të personave jo-rezidentë, mënyra më e lehtë është identifikimi i pagesave që bëhen nga persona rezidentë tatimorë shqiptarë apo nga çdo ent, organ të qeverisjes qendrore dhe vendore, etj.

Organi tatimor mund të shfrytëzojë, reklamat, njoftimet në gazeta apo media, informacionet nga bankat apo nga burime të tjera për të identifikuar të ardhurat e realizuara me burim në Shqipëri. Kur këto të ardhura realizohen nga persona jo-rezidentë, apo nga individë apo persona rezidentë shqiptarë që, në bazë të legjislacionit tatimor ekzistues, nuk janë të detyruar të regjistrohen në organet tatimore shqiptare, detyrimi tatimor do të mbahet në burim nga paguesi i të ardhurave. Në pamundësi për këtë, përfituesi i të ardhurave duhet të deklarojë dhe paguajë detyrimin tatimor në organin tatimor përkatës.

Gjithashtu, referuar nenit 33 “Mbajtja në burim e tatimit mbi të ardhurat”, të ligjit të sipërcituar përcaktohet se, të gjithë personat rezidentë në Republikën e Shqipërisë, organet e qeverisjes qendrore e vendore, organizatat jofitimprurëse dhe çdo subjekt tjetër, i njohur nga legjislacioni në



## DREJTORIA E PËRGJITHSHME E TATIMEVE

fuqi, janë të detyruar të mbajnë tatimin në burim në masën 15 për qind nga shuma bruto e pagesave të listuara në këtë nen, që lindin nga një burim në Republikën e Shqipërisë.

Në rastet kur përfituesi i të ardhurave është rezident në një nga shtetet me të cilat vendi ynë ka nënshkruar një marrëveshje tatimore (në fuqi), trajtimi fiskal për çdo rast i referohet dispozitave të marrëveshjes tatimore.

Rregullat lidhur me zbatimin e dispozitave të marrëveshjeve tatimore ndërkombëtare përcaktohen në Udhëzimin nr.6 datë 10.02.2004 “Për marrëveshjet bilaterale për shmangien e taksimit të dyfishtë dhe parandalimin e evazionit fiskal”.

Për të përfituar nga dispozitat e marrëveshjeve tatimore ndërkombëtare paguesi i shumës (tatimpaguesi rezident shqiptar) paraqet kërkesën për aplikim në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve (DPT) në përputhje me pikën 4.3 b) të Udhëzimit të mësipërm, të shoqëruar me dokumentacion e kërkuar nga dispozitat e Udhëzimit nr.6, datë 10.02.2004.

Gjejmë me vend t’ju bëjmë me dije se në pikën 4.4 të Udhëzimit të mësipërm përcaktohet se Drejtoritë Rajonale Tatimore mund të zbatojnë dispozitat e marrëveshjeve tatimore vetëm pas marrjes së një shkrese zyrtare nga DPT, e cila duhet të bazohet në dispozitat konkrete të një marrëveshje që është në fuqi.



## DREJTORIA E PËRGJITHSHME E TATIMEVE

### 3. Nga fusha e punësimit dhe sigurimeve Shoqërore

#### 3.1 *Në lidhje me dypunësimin dhe deklarimin e tyre për efekte të kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetsore.*

Në kuptim të Kodit të Punës, kur dy palë hyjnë në marrëveshje, ku njëra palë në cilësinë e punëmarrësit merr përsipër të ofrojë punën ose shërbimin e vet për një periudhë të caktuar ose të pacaktuar kohe, në kuadër të organizimit dhe të urdhrave të një personi tjetër, të quajtur punëdhënës, i cili merr përsipër të paguajë një shpërblim kemi të bëjmë me marrëdhënie punësimi, e cila rregullohet nga kontratat e punësimit me kohë të plotë apo të pjesshme sipas dispozitave ligjore të këtij kodi.

Bazuar në ligjin Nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, neni 10, pika 1, në udhëzimin Nr. 5, datë 30.01.2006, “Për Tatimin mbi të Ardhurat”, i ndryshuar, pika 2.6.1 dhe 2.6.2 përcaktohet se çdo punëdhënës, që paguan një pagë a shpërblim të parashikuar në nenin 8, gërma “a”, dhe në përputhje me nenin 9, paragrafi i parë I ligjit nr.8438, mban tatimin në burim mbi të ardhurat personale dhe e derdh tatimin e mbajtur në favor të organeve tatimore, duke përdorur deklaratën “Listëpagesa e kontributeve të sigurimeve shoqërore, shëndetsore dhe tatimit mbi të ardhurat nga punësimi” brenda afateve ligjore të përcaktuara në këto akte ligjore.

Gjithashtu sjellim në vëmendje se në referencë të Vendimit nr.77, datë 28.01.2015 “Për kontributet e detyrueshme dhe përfitimet nga sistemi i sigurimeve shoqërore dhe sigurimi i kujdesit shëndetësor”, i ndryshuar, Kreut III “Llojet, shuma dhe shpërndarja e kontributeve”, pika 15, përcaktohet se:

*Llogaritja dhe deklarimi i kontributeve mujore, për personat që janë ekonomikisht aktivë në më shumë se një subjekt juridik ose fizik bëhet si më poshtë:*

- a) *Kur i njëjti person është ekonomikisht aktiv në dy ose më shumë subjekte dhe në secilin prej tyre merr pagë më të lartë se paga minimale, llogaritja e kontributit të sigurimit shoqëror dhe sigurimit të kujdesit shëndetësor është e detyrueshme për çdo subjekt. Në këtë rast, llogaritja e kontributit të sigurimit të kujdesit shëndetësor bëhet sipas pagës përkatëse, që merr nga secili subjekt, ndërsa masa e llogaritur e kontributeve të sigurimeve shoqërore, në total të jetë jo më shumë se kontributi i llogaritur mbi pagën maksimale;*
- b) *Kur i njëjti person është ekonomikisht aktiv në dy ose më shumë subjekte, dhe në njërin prej tyre paga është më e vogël se paga minimale, llogaritja e kontributit të sigurimit shoqëror dhe sigurimit të kujdesit shëndetësor është e detyrueshme për çdo subjekt. Në këtë rast, llogaritja e kontributit të sigurimit të kujdesit shëndetësor bëhet sipas pagës përkatëse, që*



## DREJTORIA E PËRGJITHSHME E TATIMEVE

*merr nga secili subjekt, ndërsa llogaritja për kontributet e sigurimeve shoqërore, në total, të jetë jo më shumë se kontributi i llogaritur mbi pagën maksimale.*

Për sa më sipër, për të ardhurat e përfituara nga individët nga punësimi në dy apo më shumë punëdhënës, referuar dispozitave ligjore në fuqi, secili punëdhënës ku është i punësuar punonjësi llogarit, mban dhe derdh në llogari të organeve tatimore tatimin mbi të ardhurat personale nga pagat dhe shpërblimet në lidhje me marrëdhëniet aktuale të punësimit.

### 3.2 *Një trajtim mbi marrëdhënien e punësimit të vazhdueshëm dhe kontratave të shërbimit*

Bazuar në Kodin e Punës, kur dy palë hyjnë në marrëveshje, ku njëra palë në cilësinë e punëmarrësit merr përsipër të ofrojë punën ose shërbimin e vet për një periudhë të caktuar ose të pacaktuar kohe, në kuadër të organizimit dhe të urdhrave të një personi tjetër, të quajtur punëdhënës, i cili merr përsipër të paguajë një shpërblim kemi të bëjmë me marrëdhënie punësimi, e cila rregullohet nga kontratat e punësimit me kohë të plotë apo të pjesshme sipas dispozitave ligjore të këtij kodi.

Më tej, në referencë të ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, neni 10, pika 1, në udhëzimin Nr. 5, datë 30.01.2006, “Për Tatimin mbi të Ardhurat”, i ndryshuar, pika 2.6.1 dhe 2.6.2 përcaktohet se çdo punëdhënës, që paguan një pagë a shpërblim të parashikuar në nenin 8, gërma “a”, dhe në përputhje me nenin 9, paragrafi i parë I ligjit nr.8438, mban tatimin në burim mbi të ardhurat personale dhe e derdh tatimin e mbajtur në favor të organeve tatimore, duke përdorur deklaratën “Listëpagesa e kontributeve të sigurimeve shoqërore, shëndetsore dhe tatimit mbi të ardhurat nga punësimi” brenda afateve ligjore të përcaktuara në këto akte ligjore.

Një tjetër element i rëndësishëm i ligjit 8438 datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, është “*Burimi i të ardhurave*”, ku sipas përcaktimit në nenin 4, gërma b), përcaktohet se, *janë të ardhura me burim në Republikën e Shqipërisë edhe të ardhurat nga veprimtari kulturore apo sportive apo dhe nga veprimtari të tjera personale në Republikën e Shqipërisë.*

Referuar Udhëzimit nr.5, datë 30.01.2006, “Për Tatimin mbi të Ardhurat”, i ndryshuar, të dalë në zbatim të ligjit, në pikën 1.4 citohet ndër të tjera se: *përcaktimi i “burimit të të ardhurave” është i rëndësishëm për të kuptuar mënyrën e përcaktimit të detyrimit tatimor të personave rezidentë dhe sidomos për personat jorezidente, të cilët taten në Shqipëri për të ardhurat me burim në Republikën e Shqipërisë.*



## DREJTORIA E PËRGJITHSHME E TATIMEVE

Kur këto të ardhura realizohen nga persona jo-rezidentë, *individë ose persona rezidentë shqiptarë që, në bazë të legjislacionit tatimor ekzistues, nuk janë të detyruar të regjistrohen në organet tatimore shqiptare, detyrimi tatimor do të mbahet në burim nga pagesi i të ardhurave.*

*Në pamundësi për këtë, përfituesi i të ardhurave duhet të deklarojë dhe paguajë detyrimin tatimor në organin tatimor përkatës.*

Përsa i përket rezidentëve, ligji përcakton se, individët rezidentë i nënshtrohen detyrimit për tatimin mbi të ardhurat personale gjatë periudhës tatimore, për të gjitha burimet e të ardhurave (brenda dhe jashtë Republikës së Shqipërisë).

Gjithashtu, sipas përcaktimeve të nenit 13, “Deklarata individuale vjetore e të ardhurave” të ligjit nr.8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar përcaktohet detyrimi i tatimpaguesve individë, *rezidentë në Republikën e Shqipërisë, që realizojnë të ardhura të tatueshme në territorin e Republikës së Shqipërisë dhe jashtë saj, mbi kufirin prej 2 000 000lekë të ardhura bruto, të dorëzojnë deklaratën vjetore të të ardhurave pranë administratës tatimore qendrore. Deklarues të të ardhurave individuale vjetore janë edhe tatimpaguesit jorezidentë, të cilët krijojnë të ardhura të tatueshme me burim në Republikën e Shqipërisë.*

*Afati i dorëzimit të kësaj deklarate është jo më vonë se data 30 prill e vitit që pason periudhën tatimore, për të cilën bëhet deklarimi.*

Përsa i përket faktit që ju parashtrojmë, se performoni, në subjekte të ndryshme të biznesit të argetimit muzikor, dhe në mënyrë jo të rregullt, të cilët janë të regjistruar në organin tatimor, duhet të lidhni me ta kontrata bashkëpunimi (në kontratë duhet të jepen saktësisht detajet si pagesa, datat e performacës tuaj, kohëzgjatja e kontratës etj.) dhe ata duhet të mbajnë dhe derdhin për llogari të organit tatimor 15 për qind nga shuma bruto

Tiranë, më 31.08.2017